



Planuar / Doretuar Prijemno/Prodato Received/Delivroy	14-08	2023	3	viti god year
Organ /Mjesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMISHQ	5647/2023		1/7	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.853/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Kaltrina Avdullahi-Prenaj Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.853/2023 të datës 15.06.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me numër Nr.01/2023 të datës 30.05.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike „kontestim konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.853/2023 e datës 15.06.2023 e parashtruar nga ankuesi.
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër Nr.01/2023 i datës 30.05.2023, ndërsa lënda kthehet në *ri-shqyrtim dhe rivendosje* tek Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, Ministria e Punëve të Brendshme.
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Drejtori i Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën II të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë Vendim.

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenin 34 paragrafi 2 dhe 3 si dhe nenin 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht më datën 06.04.2023 ka njoftuar lidhur me konkursin me numër të referencës Nr.RN00011411, ndërsa më datë 27.04.2023 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave Politike lidhur me pozitën e punës „Zyrtar i Misionit Diplomatik” në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Në fazën e shqyrtimit paraprak Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, më datë 26.05.2023 ka nxjerr Vendim me numër Nr.9/2023 me të cilin e ka refuzuar aplikacionin me numër Nr.RAN0013455 të ankuesit me arsyetimin se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi përkatëse që ka zotësi për të vepruar me afat ashtu siç është kërkuar në konkursin me numër reference RN00011411 gjegjësisht dëshmia e bashkangjitur është me afat të skaduar.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me numër Nr.0/2023 të datës 26.05.2023, më datë 07.06.2023 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ndërsa më datën 30.05.2023 Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka nxjerrë Vendim me numër Nr.01/2023 me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar me arsyetimin se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi përkatëse që ka zotësi të plotë për të vepruar, gjegjësisht dëshmia e bashkangjitur nga ankuesi është me afat të skaduar.

Ankuesi, përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net më datë 15.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 4786/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Nr.01/2023 të datës 30.05.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me pretendimin ankimor se aplikimi nga ana e tij është kryer në përputhje me kërkesat e dokumentacionit, sipas konkursit të njoftuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.06.2023 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli më datë 22.06.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë me të gjitha shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesën me numër protokollit 4786/2023 të datës 15.06.2023 parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Certifikatë me numër CN.nr.227/22 e datës 19.07.2022; Vërtetim me numër Nr.0467 e datës 19.07.2022 e lëshuar nga Qendra për Punë

Sociale; Vendim me numër Nr.01/2023 i datës 30.05.2023; Konkurs me numër të referencës RN00011411 i datës 27.04.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 16.06.2023;

Përgjigje në ankesë e datës 22.06.2023; Njoftim për ndërprerjen e procedurës së rekrutimit; Lista e aplikantëve me numër reference RN00011411; E-maili i datës 26.05.2023; E-maili i datës 30.05.2023; Vendim me numër Nr.9/2023 i datës 26.05.2023; Vendim me numër Nr.05/142 i datës 10.05.2023; Aplikacion i datës 30.04.2023; Diplomë me numër Nr.330/0709 e datës 17.07.2009; Certifikatë e datës 29.04.2013; Vendim me numër Ref.nr.614-1149 i datës 29.07.2019; Certifikatë e datës 22.11.2022; Certifikatë; Certifikatë me numër AID 011860; Certifikatë; Certifikatë e datës 22-24.10.2018; Certifikatë e datës 8-9.12.2017; Certifikatë e muajit dhjetorë 2016; Certifikatë e muajit mars 2017; Certifikatë për muajin prill-maj i vitit 2016; Certifikatë e muajit maj 2016; Certifikatë me numër Nr.10404/15; Certifikatë 30.03.2018; Certifikatë e datës 25.11.2014; Certifikatë për vitin 2012; Certifikatë e datës 14.07.2008 deri 01.08.2008; Vërtetim me numër 02. Nr.152-3130/09 i datës 12.08.2008; Certifikatë për muajin dhjetorë 2015; Vërtetim i datës 29.07.2009; Certifikatë e datës 26.08.2020; Marrëveshje angazhimi e datës 28.09.2020; Kontratë pune për punë dhe detyra specifike; Certifikatë shëndetësore me numër Nr.373 e datës 27.04.2023; Pasqyrë e llogarisë së trustit pensional për periudhën kohore 26.12.2006 deri 18.04.2023; Vërtetim tatimor me numër Nr.1001049999 e datës 24.04.2023; Vendim me numër VK/2023 i datës 27.07.2023 për vazhdimin e afatit të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ekzistojnë rrethana dhe bazë e mjaftueshme ligjore, që ankesa e ankuesit të kthehet në *ri-shqyrtimi dhe rivendosje te organi i njëjtë*, sepse:

Kolegji i Këshillit, në bazë të vlerësimit të provave, ka konstatuar se sipas konkursit me numër reference RN00011411 me emrin e grupit Specialist të Përgjithshëm të Shkencave Politike, për pozitën e punës "Zyrtar i Misionit Diplomatik" në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në pikën 3 si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në Shkenca Politike, Administratë Publike, Politika Sociale/ Juridik.*
- *Kualifikime të posaçme formale: Njohja e gjuhës italiane në nivelin C1-C2 e obliguar . Njohja e gjuhës italiane dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime universitare të kryera në këtë gjuhë ;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së listë të punës.*

Në pikën 2. si Kërkesa të përgjithshme për pranim janë përcaktuar: *Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, Të ketë zotësi të plotë për të vepruar, të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët, Të jetë i aftë në pikëpanije shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse, Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.*

Ndërsa në pikën 7 janë përcaktuar dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin për diplomat e marra jashtë vendit.*
- *Kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet së paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale;*
- *Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;*
- *Kopjet e dëshmisë së njohjes së gjuhës Italiane, Njohja e gjuhës Italiane dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime universitare të kryera në këtë gjuhë;*
- *Dëshmi përkatëse nëse kandidati/ja ka zotësi për të vepruar;*
- *Dëshmi mjekësore se kandidati/ja është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryerjen e detyrës;*
- *Certifikatë, vërtetim nga Gjykata ose Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilin dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit;*
- *Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e kërkuar të punës, është në sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilin dëshmohet se ai/ajo nuk gjendet në kushtet parashikuara në nenin 8 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.6) të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar nëntë (9) kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi por i cili me datë 26.05.2023 përmes Vendimit me numër Nr.9/2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik është njoftuar lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë, ngase i njëjti nuk i ka plotësuar kushtet e konkursit gjegjësisht i njëjti nuk ka ofruar dëshmi përkatëse se ka zotësi të plotë për të vepruar me afat ashtu siç është kërkuar në konkursin me numër reference RN0001141. Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të ofruara nga organi i punësimit ka konstatuar se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ka publikuar njoftimin për ndërprerjen e procedurës së rekrutimit respektivisht konkursit me numër reference RN00011411 për emrin e grupit Specialist të Përgjithshëm të Shkencave Politike, për pozitën e punës "Zyrtar i Misionit Diplomatik" të datës 06.04.2023 me arsyetimin se asnjëri nga kandidatet që kanë aplikuar nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit për të vazhduar më tutje në procedurë të rekrutimit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe juridike me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.01/2023 të datës 30.05.2023 për refuzimin e ankesës së tij lidhur mos përfshirjen në listën e ngushtë sepse aplikimi nga ana e tij është kryer në përputhje me kërkesat dhe dokumentacionin e kërkuar sipas konkursit të njoftuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i 'u referua dispozitave ligjore në fuqi përkitazi me procedurën e pranimit të nëpunësve civil, gjegjësisht: Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, ku me nenin 34 paragrafi 5, 6 dhe 7 përcaktohet: ". 5. Shpallja e konkursit, sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfshin përshkrimin e përgjithshëm të punës për grupin përkatës, pozitën e punës të lira në grupin përkatës, kriteret që duhet t'i plotësojnë kandidatët, afatin për aplikim, të dhënat e hollësishme për zhvillimin e procesit të përzgjedhjes dhe dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim". 6. Konkurrimi zhvillohet në dy faza: 6.1. verifikimi paraprak, nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; 6.2. vlerësimi i njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 7. "Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia e përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komisioni i pranimit (në vijim: Komisioni i pranimit), i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë për të cilin zhvillohet konkurrimi...." Ndërsa me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 10 parasheh se: 1."Shpallja e konkurrimit për një Grup të caktuar përmban, të paktën, këto të dhëna: 1.1. përshkrimin e përgjithshëm të punës së Grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 1.2. Kërkesat e përgjithshme për pranim sipas nenit 8 të LZP; 1.3. kërkesat e përgjithshme formale; 1.4. njohuritë, aftësitë dhe cilësitë që vlerësohen në procedurën e konkurrimit (kërkesat e përgjithshme të nevojshme); 1.5. listën e pozitave, aktualisht të lira, të Grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 1.6. mënyrën për paraqitjen e aplikacioneve; 1.7. afatin përfundimtar për pranimin e aplikacioneve të përcaktuara me datë të saktë kalendarike; 1.8. dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikacionit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre; 1.9. mënyrën e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve; 1.10. mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët..." neni 14 përcakton se: 1."Konkurimi për pranimin në shërbimin civil, përfshin dy faza: 1.1. Verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2" Vlerësimi i Kandidatëve". Neni 15 përcakton se: 1."Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim". 2."Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak". 3."Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë". 4."Kandidatët të cilët plotësojnë kushtet për aplikim renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Lista shpallet në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve". 5."Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katërmbëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve"..... rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, referuar dispozitave të cekura si më lartë si dhe provat e lëndës të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit ka konstatuar se ankuesi me rastin e aplikimit në këtë konkurs si dëshmi përkatës që ka zotësi për të vepruar ka bashkangjitur: Certifikatën me numër CN.nr.227/22 të datës 19.07.2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore Pejë-Dega Klinë si dhe Vërtetimin me numër Nr.0467/22 të datës 19.07.2022 të lëshuar nga Qendra për Punë Sociale-Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Klinës, ndërsa në konkursin me numër reference RN00011411 për emrin e grupit „Specialistë i Përgjithshëm të Shkencave Politike” për pozitën e punës „Zyrtar i Misionit Diplomatik” në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Diasporës në pjesën e shtatë (7) të konkursit në pikën 5 është përcaktuar „Dëshmi përkatës se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar” gjegjësisht Kolegji ka konstatuar se në konkursin e lartpërmendur nuk është përcaktuar ndonjë afat i vlefshmërisë së akteve

(certifikatës apo vërtetimit), e gjithashtu as në Certifikatën e nxjerrë nga Gjykata Themelore e Pejës dega në Klinë e as në Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale/Qendra për punë Sociale në Komunën e Klinës nuk përmbajnë afat kohor të skadimit të këtyre akteve.

Kolegji i Këshillit në funksion të shqyrtimit të themelësisë së pretendimeve ankimore ka analizuar Vendimin me numër Nr.01/2023 të datës 30.05.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për refuzimin e ankesës se tij lidhur mos përfshirjen në listën e ngushtë dhe si rrjedhojë ka konstatuar së i njëjti bazohet në vërtetim jo të drejtë të gjendjes faktike dhe zbatim jo të drejtë të dispozitave materiale, pasi që sipas vlerësimit të Kolegjit, Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, fare nuk ka shqyrtuar pretendimet ankimore, të ankuesit lidhur me ankesën për mos përfshirjen në listën e ngushtë dhe se i njëjti me marrjen e vendimit me numër Nr.01/2023 të datës 30.05.2023 nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse ankuesi nuk është përfshire në listën e ngushtë edhe përkundër se ai ka dorëzuar me rastin e aplikimit dokumentet ashtu siç është kërkuar në konkursin e datës 06.04.2023, gjegjësisht nuk i është referuar asnjë baze ligjore lidhur me afatin e vlefshmërisë së akteve (certifikatës apo vërtetimit). Andaj, Kolegji konstaton se Vendimi me numër Nr.01/2023 i datës 30.05.2023 nuk i përmban elementet e detyrueshme të aktit administrativ të përcaktuara me nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nga rrjedh se si i tillë Vendimi është i kundërligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.4 dhe 1.5 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material”*.

Meqenëse vendimi i atakuar përmban të meta të tillë të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit vlerëson se Vendimi me numër Nr.01/2023 i datës 30.05.2023 i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, është i paligjshëm dhe si i tillë është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa lënda e ankuesit është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë tek Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, kurse me rastin e rishqyrtimit të lëndës Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik duhet të shqyrtoj të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit të paraqitura në ankesën e datës 28.05.2023, të shqyrtoj të gjitha dokumentet e dorëzuara si dhe të marr parasysh vendimet tjera të cilat i njëjti organ i ka lëshuar për objekt të njëjtë lidhur me konkursin e datës 06.04.202 si dhe të marr për bazë vërejtjet e dhëna ligjore si në arsyetimin e këtij vendimi, ndërsa me rastin e vendosjes së lëndës të nxjerrë akt administrativ duke e arsyetuar të njëjtin siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe në mbështetje të ligjit material.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit

Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër Vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.853/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/MPB;
- Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit-DMZP-MPB; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.